

Këshilli Investimeve në Shqipëri

PROBLEMATIKA TË SEKTORIT PRIVAT TË TRAJTUARA GJATË VITIT 2018

Në përputhje me rezultatet e votimit të temave për t'u diskutuar nga Këshilli i Investimeve, tematikat e mëposhtme ishin pjesë e axhendës së KI gjatë 2018:

1. *Platforma Elektronike për Lejet e Ndërtimit dhe Impakti i saj në Përmirësimin e Klimës së Investimeve*
2. *Kuadri Ligjor mbi Investimet në Shqipëri, Debatet dhe Sfidat*
3. *Mbi Formalizimin dhe Konkurrueshmërinë në Turizëm*

A është platforma e e-Lejeve sportel shërbimi me një ndalesë për biznesin?

Platforma elektronike për lejet e ndërtimit u nis nga Qeveria Shqiptare si një instrument për të lehtësuar procedurat dhe për të rritur transparencën për publikun, në kuadër të Reformës së Derregullimit. Qëllimi i Mbledhjes së KI mbajtur më 13 shkurt 2018 ishte të jepej një vlerësim mbi funksionimin e platformës së e-Lejeve dhe impaktit të saj në lehtësimin e procedurave të ndërtimit për investitorët.



Sekretariati përfshiu në analizën e tij mendime dhe sugjerime gjithëpërfshirëse të rreth 66 profesionistëve duke synuar trajtimin e çështjeve ligjore & rregullatore, institucionale dhe teknike që përbënin shqetësim për përdoruesit e platformës (investorë, arkitektë, urbanistë, bashki, agjenci qeveritare etj.). Gjetjet dhe rekomandimet e analizës synonin të jepnin qartësi dhe përgjigje mbi pyetjet:

- A është platforma e e-lejeve një sportel shërbimi me një ndalesë?
- A ka disiplinuar procedurat e aplikimit dhe vlerësimit duke marrë parasysh afatet, procedurat dhe dokumentet e kërkuara?
- A ka nxitur platforma koordinimin efikas institucional?

REKOMANDIMET KRYESORE

- Përgatitja nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)/Agjencia për Zhvillimin e Territorit (AZHT) i një **manuali të detajuar operacional, teknik dhe ligjor** në formën e një Udhëzimi për të gjithë përdoruesit. Manuali duhet të vihet në dispozicion për të gjithë përdoruesit e platformës, në veçanti bashkitë, dhe AIDA duhet të promovojë shërbimet e platformës me një ndalesë tek investitorët potencialë.
- **Pezullimi i platformës**, kur është e nevojshme, duhet të bëhet vetëm mbi baza ligjore.
- **Unifikimi i tarifës** për shqyrtimin e aplikimit për lejet e ndërtimit në platformën e-leje.
- **Trajnim dhe kualifikim i vazhdueshëm** i burimeve njerëzore të përfshira direkt në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit nëpërmjet platformës së e-lejeve. Konsolidimi i strukturave të dedikuara vetëm për këtë proces.
- **Rritja e transparencës** në vendimmarrje për aplikimet nëpërmjet platformës duke mundësuar seanca dëgjimore të strukturuar me aplikuesit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.
- **AZHT** duhet të pajiset nga legjislacioni me atributet e plota të **administratorit** ligjor dhe teknik të platformës e-lejet.

A është kuadri ligjor aktual për investimet motivues dhe 'lehtësisht i aplikueshëm' për investitorët?

Miratimi i Ligjit të Unifikuar të Investimeve është një angazhim i ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare për të zëvendësuar Ligjin 'Për Investimet e Huaja' (1993) dhe Ligjin 'Mbi Investimet Strategjike' (2015),

sikurse përshirë gjithashtu edhe në Axhendën Rajonale të Reformës së Investimeve (RIRA).

Një tryezë e gjerë konsultimi u mbajt më 23 maj 2018, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertë të IFC, Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë dhe Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Në mbledhje morën pjesë mbi 60 përfaqësues të biznesit vendas dhe të huaj si dhe shoqata të biznesit. Diskutimet u fokusuan mbi praktikën më të mira ndërkombëtare dhe sfidat për një kuadër bashkëkohor ligjor mbi investimet, me fokus përmirësimin e legjislacionit mbi investimet, incentivat, dhe mekanizmat për zgjidhjen e ankesave të investitorëve, etj. Pjesëmarrësit theksuan rolin e mekanizmave shtetërorë për zgjidhjen e ankesave të investitorëve si tepër të rëndësishëm por nënvizuan se mekanizma të tilla nuk duhet të mbivendosen me struktura të ankimit administrativ të cilat ekzistojnë aktualisht.

Qëllimi i Mbledhjes së KI mbajtur më 18 qershor 2018 ishte prezantimi dhe evidentimi i gjetjeve kryesore nga procesi i diskutimit me aktorë mbi nevojën për një ligj të unifikuar të investimeve.



Në Përmbledhjen e përgatitur nga Sekretariati, ku u paraqitën edhe disa modele të mekanizmave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investitorëve, fokusi u mbaj mbi çështjet e mëposhtme:

- A është kuadri ligjor aktual i harmonizuar me rekomandimet e praktikave më të mira si p.sh. rekomandimet e UNCTAD?
- A është ky kuadër motivues dhe 'lehtësisht i aplikueshëm' për investitorët vendas dhe të huaj që zgjedhin Shqipërinë si destinacion për investime të reja?

PËRFUNDIMET KRYESORE

- **Një ligj i ri i investimeve mund të sjellë një imazh të ri në vend** duke krijuar një ligj më të fortë, përputhje më të madhe me politikat rajonale dhe dispozitat e Traktateve Dypalëshë të Investimeve (BIT).
- Vizioni i qeverisë mbi politikat e investimeve kushtëzohet nga mirë-funksionimi i **institucioneve të qëndrueshme dhe të besueshme**.
- **Mekanizmat për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve** janë shumë të rëndësishme për identifikimin e çështjeve sistematike, rritjen e ndërgjegjësimit, dhe gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta pa kosto.
- **Incentivat duhet të jenë të matshme dhe të arritshme** nga investitorët.
- **Nuk duhet të ketë dallime midis investitorëve vendas dhe të huaj**. Është e rëndësishme për investitorët e të gjitha kategorive (të vegjël, mesëm, mëdhenj) që të jenë të mbrojtur në mënyrë të barabartë.

Në çfarë shkalle informaliteti pengon konkurrencën në sektorin e turizmit?

Qëllimi i Mbledhjes së KI mbajtur më 15 tetor 2018 ishte të diskutohej shkalla në të cilën konkurrueshmëria e sektorit të turizmit pengohet nga aktiviteti informal dhe evazioni fiskal, si dhe dhënia e rekomandimeve të mundshme që mund të adresojnë shqetësime të tilla.

Analiza e Sekretariatit u përpoq të identifikojë masat fiskale, ligjore dhe rregullatore, të nevojshme për të adresuar informalitetin e lartë të sektorit, dhe përafrimin e tyre me kuadrin e përgjithshëm të politikave dhe strategjive për zhvillimin e sektorit. Fillimisht u ndërmor një anketë në nivel kombëtar (me rreth 157 kompani të sektorit), pasuar me tre mbledhje rajonale konsultimi në Durrës, Gjirokastrë dhe Korçë me 65 biznese me veprimtari në sektorin e turizmit, dhe një mbledhje në nivel teknik në Tiranë me pjesëmarrjen e 20 aktorëve.




REKOMANDIMET KRYESORE

- **Finalizimi dhe miratimi i Strategjisë së Turizmit** – përafrimi i objektivave mes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në lidhje me veprimet, masat konkrete dhe agjencitë përgjegjëse për të adresuar informalitetin në sektor. Më konkretisht, duhet të përcaktohen afate dhe veprime/masa të qarta formalizimi për të përmbushur objektivat e draft strategjisë në turizëm: "regjistrimi 80% i akomodimit në familje (dhoma, apartamente, shtëpi) brenda vitit 2022". Veprime dhe metoda konkrete që trajtojnë çështjet e formalizimit (identifikimit dhe regjistrimit) mund ta bëjnë të mundur realizimin e objektivit të strategjisë.

- Modeli i biznesit dhe karakteristikat e informalitetit janë të ndryshme sipas tipologjive të destinacioneve turistike. Duke patur parasysh që informaliteti në sektor mbetet sistemik, sugjerohet që **strategjitë e formalizimit të përshtaten në përputhje me veçoritë e modelit të biznesit dhe profilit të turizmit sipas qytetit.**
- **Identifikimi dhe regjistrimi i strukturave akomoduese** mund të finalizohet me një etiketim të thjeshtë të operatorëve formalë në sektorin e turizmit – ku të thuhet se operatori njihet si i regjistruar dhe se paguan rregullisht taksat dhe detyrimet. Ky është një hap paraprak deri sa të konsolidohet Regjistri Kombëtar.
- **Programet e edukimit dhe informimit të subjekteve mbi formalizimin duhet të koordinohen dhe zhvillohen për Administratën Tatimore dhe Inspektoriatet** që monitorojnë përputhshmërinë e tregut. Kjo duhet të zbatohet rregullisht dhe jo vetëm gjatë sezonit turistik, pasi veprimet e ndërmarra gjatë sezonit turistik kanë patur një impakt negativ tek aktiviteti i biznesit dhe perceptimi i turistëve.

Analiza e Sekretariatit konfirmoi se ajo që prek ndjeshëm impaktin e çdo politike në fushën e taksave mbi informalitetin është ana e 'butë' e masave të informalitetit – inspektorë profesionistë, raportim i qartë dhe shumë i saktë pas çdo inspektimi dhe shkëmbim informacioni midis autoriteteve tatimore dhe bizneseve.

Anketa e KI 2018 – Perceptimi i Biznesit mbi Klimën e Investimeve në Turizëm



1-e pafavorshme 5- shumë e pafavorshme

ANËTARËSIA E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE GJATË 2018

Anëtar, Institucion Shtetëror	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Anëtar, Institucion Shtetëror	Banka e Shqipërisë
Anëtar, Institucion Shtetëror	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Anëtar, Institucion Shtetëror	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
Anëtar, Institucion Shtetëror	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)
Anëtar, Partner Zhvillimi	Banka Botërore
Anëtar, Partner Zhvillimi	Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri
Anëtar, Partner Zhvillimi	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)
Anëtar, Partner Zhvillimi	Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC)
Anëtar, Përfaqësues Biznesi	Albstar Shpk
Anëtar, Përfaqësues Biznesi	Ferra Co
Anëtar, Përfaqësues Biznesi	BKT
Anëtar, Përfaqësues Biznesi	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA)
Anëtar, Përfaqësues Biznesi	Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë
Anëtar, Përfaqësues Biznesi	Bashkimi Tregtar Shqiptar (BTSH)

Informacion në Shifra për Vitin 2018

Mbledhje Plenare të KI	3
Rekomandime të Miratuara	33
Intervista dhe Takime Individuale	61 aktorë
3 Mbledhje Rajonale	65 kompani
1 Mbledhje në Nivel Teknik	20 pjesëmarrës
1 Tryezë e Rrumbullakët	64 pjesëmarrës
Anketa e KI për 2018	357 të anketuar në shkallë vendi
Niveli i Pjesëmarrjes në Mbledhjet e KI	89%
Dorëzimi i Rekomandimeve të KI	40 institucione/ambasada të KI

Publikuar nga: Këshilli Investimeve (KI)

Dëshmorët e Kombit,
Tiranë, Shqipëri
T. +355 692631300
info@investment.com.al
www.investment.com.al

KI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.